Ngjarje tragjike në Divjakë! Burri vret gruan dhe më pas veten

Shpërndaje

Në foto shtëpia ku ndodhi krimi & djali i viktimave

18:49 18/09/2021

Një ngjarje tragjike ndodhi këtë të shtunë në fshatin Babunjë të Divjakës. Për shkaqe që ende nuk dihen, **Hekuran Rrasa**, **58 vjeç,** vrau me armë zjarri gruan e tij **Fëllënxë Rrasa, 45 vjeçe**. Më pas 58-vjeçari i dha fund jetës.

Ngjarja e rëndë ndodhi në shtëpinë e bashkëshortëve. Burime zyrtare të policisë thonë se krimin Hekuran Rrasa e kreu me armë gjahu, e cila u gjet në vendin e ngjarjes.

Rrethanat e këtij krimi të dyfishtë nuk dihen ende. Dyshimet e para janë që gjithçka ka ndodhur për motive të dobëta. Mësohet se ka qenë djali i viktimave, i cili i ka gjetur prindërit të pajetë në shtëpi.

Burime nga policia për Klan News thonë se gjatë ditës së sotme nuk ka pasur asnjë konflikt që të jetë raportuar mes bashkëshortëve, të paktën deri në deklaratat e mbledhura deri më tani.

"*Në fshatin Babunjë, Divjakë, dyshohet se Hekuran Rrasa, 58 vjeç, ka vrarë me armë gjahu në banesë bashkëshorten e tij, Fëllënxë Rrasa, 45 vjeçe dhe më pas ka vrarë veten. Në vendngjarje është gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provës materiale arma e gjahut. Grupi hetimor nën drejtimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lushnjë vijon punën për sqarimin e plotë të rrethanave të ngjarjes",* tha **Policia** në një njoftim paraprak për mediat.

Krimi i dyfishtë në Divjakë, gazetarja: Dhuna në familjen Rrasa ishte e kahershme. Trupat u gjetën nga djali 20-vjeçar

Dhuna në familjen Rrasa duket se ishte prezente prej vitesh, por pak kush imagjinonte se këtë të shtunë, Hekuran Rrasa do të vriste me armë zjarri bashkëshorten e tij Fëllënxë Rrasa, 45 vjeçe, e më pas do të vetëvritej. Gazetarja Anila Sefa, nga fshati Babunjë i Divjakës ku ndodhi ngjarja e rëndë, solli më shumë detaje.

"Shpeshherë ata kanë qenë çift i njohur në komisariatin e Divjakës për shkak të dhunës. Prej kohësh ajo ka pas kërkuar dhe urdhër mbrojtje, por nuk e ka rinovuar më. Debati mes tyre ka qenë i kahershëm", tregoi Sefa.

Gazetarja tha se 58-vjeçari, përveç sjelljes së dhunshme, dyshohet se kohët e fundit kishte shfaqur edhe probleme të shëndetit mendor. Sefa, duke cituar burime nga policia e Divjakës tha se kohë më parë, gruaja kishte kërkuar urdhër mbrojtje, megjithatë kohët e fundit nuk kishte pasur më denoncime në polici. Nga ana tjetër, edhe në rastet e mëparshme kur Fëllënxë Rrasa e kishte denoncuar të shoqin për dhunë, e kishte tërhequr denoncimin.

Çiftit jetonte me djalin e tyre 20-vjeçar. Ishte pikërisht ky i fundit i cili pasi dëgjoi të shtënat me armë vrapoi drejt shtëpisë. Ai gjeti të ëmën e pajetë brenda banesë dhe lajmëroi xhaxhain. Kur u rikthyen, ata zbuluan edhe trupin e Hekuran Rrasës.

Gazetarja Anila Sefa tregoi po ashtu se ata jetonin në gjendje të rënduar ekonomike dhe se autori ishte edhe përdorues i alkoolit, megjithatë kohët e fundit duket se po përpiqej të hiqte dorë.

Autori i krimit punonte në Bashkinë e Divjakës së bashku me djalin, ndërsa bashkëshortja merrej me punë bujqësie.

"Dua ndihmë nga Zoti, unë jam mes të rrugës…", reagimi mes lotësh i 20-vjeçarit që gjeti të vdekur prindërit në shtëpi

"Sillej shumë mirë. Unë kam qenë për kafe, më lajmëruan në telefon… Ju lutem unë dua ndihmë nga Zoti, unë jam mes të rrugës…" Mes lotësh dhe i tronditur, ky është reagimi i parë i djalit të çiftit Rrasa, i cili këtë të shtunë gjeti të vdekur në shtëpi të dy prindërit e tij, nënën 45-vjeçare Fëllënxë Rrasa dhe të atin 58-vjeçar Hekuran Rrasa. Ky i fundit dyshohet se pasi vrau bashkëshorten i dha fund jetës me armë zjarri.

Shkaqet dhe rrethanat e ngjarjes së rëndë mbeten të paqarta. Për gazetaren Anila Sefa, burime nga policia, por edhe fqinj të çiftit që jetonte në fshatin Babunjë, flasin për dhunë të herë pas hershme në këtë familje. Por nga ana tjetër, vëllai i 58-vjeçarit Hekuran Rrasa, e mohon këtë. Ai pranon se i vëllai konsumonte alkool, por thotë se nuk e dhunonte bashkëshorten.

Siç mund të shihet edhe në pamje, çifti jetonte në kushte të vështira ekonomike.

/tvklan.al

TË NGJASHME



Policia mbërrin në shtëpinë e ish-Kryeprokurorit, Adriatik Llalla

18:26 22/09/2021

Policia pritet të mbërrijë në shtëpinë e Llallës, gruaja e tij u tregon gishtin gazetarëve

17:35 22/09/2021

E përplasi makina, këmbësori niset me helikopter drejt Tiranës

16:21 22/09/2021

Apeli e dënoi me 2 vjet burg, SPAK nxjerr urdhërarrestin ish-Kryeprokurorin Adriatik Llalla

15:53 22/09/2021

Bie nga ballkoni, ndërron jetë 6-vjeçari

14:15 22/09/2021

U dënua me 2 vite burgim, Klan News në shtëpinë e ish-kryeprokurorit Adriatik Llalla

13:09 22/09/2021



Apeli dënon Adriatik Llallën me 2 vite burgim

12:17 22/09/2021

Furgoni i Burgjeve që transportonte Sokol Sanxhaktarin përplaset me karrocën

11:51 22/09/2021



Kamioni përplas për vdekje biçiklistin në Tiranë

10:48 22/09/2021

PROGRAME
OPINION
E DIELA SHQIPTARE
STOP
RUDINA
ZONË E LIRË
KLANIFORNIA
LOVE STORY
ALDO MORNING SHOW
AROMË DREKE
HISTORIA IME
JO VETËM MODË
HISTORI SHQIPTARE
KËNGA MAGJIKE
PRO BUSINESS
UNIKO
DIAGNOZË

LAJMET
ZGJEDHJET 2021
CORONAVIRUS
POLITIKA
EKONOMI
KRONIKË
AKTUALITET
KOSOVA
RAJONI
BOTA
TEKNOLOGJI
SPORT
SHOWBIZ
KURIOZITETE
SHËNDET
KULTURË
LIFESTYLE

TË TJERA
KLAN NEWS
KLAN PLUS
KLAN MACEDONIA
GUIDA
HOROSKOPI
MOTI
ANALIZA
LAJMET E FUNDIT
KALLËZO
EDICIONI INFORMATIV
LAJME NGA EMISIONET
LAJME NGA EDICIONET
LAJME LOVE STORY
KUICE
VIDEO
FOTOGALERI
ARKIVA KLAN 1998 -2012

SERIALE
DOKTORI I MREKULLIVE
OSMANI
SHTËPIA IME, FATI IM
VIKINGËT
KAMPIONI IM
LULE TË VETMUARA
ÇUKUR
KRYEQYTETI ABDULHAMID
LISTA E ZEZË
DYSHJA FANTASTIKE
KUZGUN (KORBI)
SULEJMANI I MADHËRISHËM
INTRIGAT E PUSHTETIT
NARCOS (TRAFIKANTËT)
BABIL (ZGJEDHJA)

RRETH NESH PRIVATËSIA ANKESA KONTAKT

© 2021 TV Klan. All Rights Reserved.